Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0804

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vedat Poterqoi -Kryetar, Isa Hasani dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani si anëtar, duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "Pro&Co" Sh.P.K. të datës 17.10.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Këshilli Gjyqësor i Kosovës të datës 02.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Prizren - Faza e parë" me numër të prokurimit 328-23-6245-5-1-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë 17.01.2024merr këtë:

Vendim

1.**APROVOHET pjesërishtë e bazuar** ankesa e operatorit ekonomik "Pro&Co" Sh.P.K. me nr. 2023/0804 e datës 17.10.2023 dhe Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Këshilli Gjyqësor i Kosovës të datës 02.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Prizren - Faza e parë" me numër të prokurimit 328-23-6245-5-1-1 anulohet, ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në ri-vlerësim.

2. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Këshilli Gjyqësor i Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 20.06.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i

objektit të Gjykatës Themelore në Prizren - Faza e parë" me numër të prokurimit 328-23-6245-5-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 2,500,000.00€.

Me datë 02.10.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë grupin e operatorëve ekonomik "EBK Sh.P.K. & U-Unique Sh.P.K. & Pro ARK Construction Sh.P.K".

Me datë 07.10.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 të Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 11.10.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar në tërësi kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Me datë 17.10.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/0804.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim:

Pretendimi i parë (I) - "*Me datën 23.06.2023, është publikuar njoftimi për kontrate, projektet janë kërkuar për periudhën kohore 3 vite pas publikimit të njoftimit për kontratë. Lideri i grupit të GOE të rekomanduar për dhënie të kontratës ka prezantuar projekte të cilat shumica janë të realizuara nga operatori tjetër ekonomik i radhitur i dyti për nga çmimi Construmax SHPK. AK të njëjtën referencë dhe të njëjtin projekt ka pranuar si të mirëqenë për dy operatorët ekonomik veç e veç. AK ligjërisht do të duhej të bënte ndarjen e punëve të realizuara nga OE EBK dhe Construmax Sh.P.K., konkretisht në kuptim të nenit 59 dhe 72 të LPP të kërkonte sqarim raporte të pranimit teknik të punëve, transaksione bankare apo edhe marrëveshjet e konzorciumit në atë mënyrë që të verifikonte nëse OE i rekomanduar për dhënie të kontratës e plotëson kërkesën dhe vlerën kualifikuese të përcaktuar në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Kjo çështje nuk është trajtuar fare me kërkesën për rishqyrtim dhe nuk është dhëne argument ligjor mbi arsyet e refuzimit të kërkesës tonë. Për këtë çështje ekzistojnë interpretime të KRPP dhe vendime*

të OSHP ku kanë gjykuar ndryshe nga AK. Si provë përveç shumë vendimeve të publikuara në web-faqe të OSHP për konsistencë mund ti referoheni vendimit me numër 1041/20 të datës 17/12/2020. Për më tepër grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka prezantuar projekte të cilat ende nuk janë të përfunduara apo në realizim e sipër, ndërsa AK ka pranuar të njëjtat projekte, ka pranuar fatura të cilat nuk korrespondojnë me kërkesën kualifikuese të përcaktuar në dosje të tenderit".

Pretendimi i dytë (II) -"*Te kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, AK ka kërkuar edhe staf të kualifikuar përfshirë menaxher të projektit, dëshmi, kontrata të punës, marrëveshje, CV të nënshkruara dhe të noterizuara. OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka prezantuar menaxher të projektit ku shifet qartë se dallojnë nënshkrimet nga ma rrëveshjet e bashkëpunimit, kontrata dhe CV, rrjedhimisht jo të gjitha shkresat dhe dokumentet e dedikuara për nënshkrim nga menaxheri i prezantuar i projektit* nuk janë të nënshkruara personalisht, dhe nga kjo neve si kompani i kemi dilemat tona i njëjti OE ka prezantuar shkresa fiktive".

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 52, 59, 60, 69 dhe 108A të LPP. Operatori ekonomik ankues ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues që të miratohet ankesa ashtu që të kthehet lënda në Rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 26.10.2023 ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 08.11.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim "*ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK*".

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimin e parë (I) ankimor, eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: "*Eksperti shqyrtues lidhur me këtë pretendim sqaron se GOE i rekomanduar për kontratë për periudhën e kërkuar nga autoriteti kontraktues lidhur me kontratat dhe referencat, e ka dorëzuar një listë të kontratave për*

liderin EBK në vlerë prej 3,760,854.87 euro, për anëtari konzorciumit U-Unique në vlerë prej 720,356.33 euro ndërsa për anëtarin tjetër të konzorciumit Pro ARK Construction në vlerë prej 1,580,000.00 euro, pra gjithsej kontratat kanë vlerën prej 6,063,211.20 euro. Eksperti shqyrtues e vlerëson si të pa bazuar pretendimin e OE ankues për faktin se konzorciumi në fjalë ka dorëzuar kontrata dhe referenca me vlerë shumë herë më të lartë se sa ka kërkuar autoritetit kontraktues dhe njëherit sqaroj se pretendimi për të ndarë vlerat e kontratave në këtë rast është i paqëndrueshëm sepse vlera e kontratave
të dorëzuara nga konzorciumi i rekomanduar për kontratë e tejkalon vlerën prej 3,000,000.00 eu ro".

Lidhur me pretendimin e dytë (II) ankimor, eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: "*Eksperti shqyrtues në përgjigje të pretendimit të OE ankues, me datën 06.11.2023*
i është drejtuar me shkrim menaxherit të projektit z. Bekim Mujajt për të dhënë sqarimin se a jan ë nënshkruar dëshmitë e dorëzuara në ofertë nga ana e vet z. Mujaj". Me këtë rast është konfirmuar se të gjitha dokumentet relevante janë të nënshkruara nga personi në fjalë sikurse kërkohet me dosjen e tenderit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat për të pretendohet nga operatori ekonomik ankues.

Ankuesi pretendon se oferta e GOE të rekomanduar për kontratl, siç janë EBK sh.p.k & U-Unique & Pro Ark Construksion shpk, dhe GOE e dytë më e lirë Construmax shpk & Harst Group shpk, janë paraqitur me referenca të njëjta dhe kjo është e papranueshme pasi që kërkesat për Kapacitetin Teknik dhe profesional janë identike për të gjithë ofertuesit: "Ofertuesit duhet të ofroj dëshmi apo kontrata pune te përfunduara të lëmisë së ndërtimit tre (3) vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, vlera e përgjithshme monetare e punëve të ekzekutuara për operatorin ekonomik ose grupin e operatorëve ekonomik jo më të vogël se 3 milion euro. Dhe si dëshmi dokumentare është kërkuar një listë të kontratave të realizuara duke plotësuar Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit, datën e përfundimit dhe emrin – institucionin e përfituesit.. Listës sipas renditjes ti bashkangjiten referencat ose raportet e pranimit".

Në bazë të pretendimeve të paraqitura nga Operatori Ekonomik (OE) ankues, referencat e paraqitura dhe ato që kanë përmbushur kërkesën për projektet e 3 viteve të fundit nga GOE i rekomanduar janë identike me ato të paraqitura për të përmbushur kërkesën nga GOE i dyti më i lirë në këtë ofertë. Në këtë kontekst, janë vërejtur disa projekte të përbashkëta si: (përmendi disa nga projektet: Renovimi i Komunës – Përdhesës dhe kulmit në Prizren, aneks kontrata për këtë projekt Loti 1 dhe 2; Ndërtimi i sallës se edukatës fizike ne shkollën Deshmorët e Zhurit faza II është projekt i Përbashkët; Ndërtimi i ndërtesave qeveritare dhe institucioneve Arsimore, kontratë kjo e lidhur me Ministrinë e Administratës Publike – MAP etj

GOE ankues, në pretendimin e tij, ka kërkuar në kërkesën për rishqyrtim që ky pretendim të trajtohet, dhe gjithashtu ka përfshirë këtë ankesë në shqyrtimin e Organin Shqyrtues të

Prokurimeve (OSHP). Eksperti shqyrtues, lidhur me këtë pretendim sqaron se konzorciumi OE i rekomanduar për kontrate, për periudhën e kërkuar nga autoriteti kontraktues,lidhur me kontratat dhe referencat, sqaron se e ka dorëzuar një listë të kontratave me vlerë prej : Lideri OE EBK, ka dorëzuar listën e kontratave ne vlerë prej: 3,760,854.87 euro. Anëtari i konzorciumit U-Unique: 720,356.33 euro. Anëtari tjetër i konzorciumit Pro ARK Construcion: 1,580,000.00 euro. Totali: 6,063,211.20 euro. Eksperti shqyrtues vlerëson si te pa bazuar pretendimin e OE ankues për faktin se konzorciumit ne fjalë ka dorëzuar kontrata dhe referenca me vlerë shumë herë më të lartë se sa ka kërkuar autoriteti kontraktues dhe njeherit sqaroj se pretendimi për te ndarë vlerat e kontratave në rast është i paqëndrueshëm sepse vlera e kontratave te dorëzuara nga konzorciumi i rekomanduar për kontrate e tejkalon vlerën prej: 3,000,000.00 euro.

Paneli shqyrtues duke ju referuar pretendimeve të Operatorit Ekonomik (OE) ankues dhe dëshmisë dokumentare të paraqitura, konstatojnë se ky pretendim nuk është trajtuar me meritë nga eksperti shqyrtues, për shkak se eksperti tek konstatimi i tij/saj nuk është ndalur fare tek fakti se në listat e projekteve paraqitur nga dy Grupet e Operatorëve Ekonomik të cilët janë kualifikuar që të dy si të përgjegjshëm dhe evidentohet se disa nga referencat janë të njëjta dhe janë paraqitur nga të dy GOE, po ashtu, eksperti shqyrtues nuk ndalet edhe tek fakti tjetër se në listën e OE të rekomanduar për kontratë ka kontrata të cilat nuk kanë përfunduar ende, me çrast eksperti shqyrtues i ka marrur të gjitha si të mirëqena duke e përfshirë totalin e tyre, pa u ndalur fare në trajtimin e tyre. Duke mos e marrur parasysh edhe faktin që këto referenca kanë vlera të konsiderueshme dhe mund të ndikojnë në përgjegjshmërinë e OE ofertues, pasi që vlera e këtyre tre kontratave është 2,052,997.82 euro, një shifër që mund të ketë ndikim drejtpërsëdrejti në vlerësimin e përgjegjshmërisë së operatorit ekonomik. Po ashtu, nuk është marrur fare edhe faktin tjetër se në listat e projekteve janë paraqitur edhe disa projekte nga GOE i rekomanduar për kontrata për kompani private dhe persona privatë. Kështu që, për projektet që janë në fazën e realizimit mund të konsiderohen si punë në progres dhe AK, gjatë rivlerësimit nuk duhet ti konsiderojë ato si projekte të përfunduara, pa pasur ne dispozicion procesverbal pranimi teknik ose referenca përkatëse.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në faktin që referencat për kontratat paraprake të realizuara nga Grupi i Operatorëve Ekonomik janë lëshuar në emër të Grupit (konzorciumit) të përbashkët për projektet e caktuara në emër të EBK & Construmax, ndërkohë që tani në këtë procedurë kemi të bëjmë për një aktivitet tjetër të prokurimit ku kanë aplikuar të dy OE, me çrast të dy janë të përgjegjshëm dhe të dy kanë paraqitur të njëjtat referenca, dhe ata kanë aplikuar ndaras dhe jo si një grup i përbashkët, atëherë, paneli shqyrtues konsideron parimisht se këto referenca duhet ti merren si të mirëqena vetëm OE i cili ka qenë lideri në ato kontrata paraprake të realizuara si Grup, kur në vendin tonë është i njohur fakti se shumica e Konzorciumeve themelohen vetëm për të plotësuar kapacitetet e njërit anëtar të konzorciumit, e në fakt nga anëtari i konzorciumit i cili nuk është lider i konzorciumit nuk kryen as edhe një punë (ky fakt mund të vërtetohet edhe me transaksionet dhe faturat e paraqitura nëpër kontrata të ndryshme kur kemi të bëjmë me konzorciume) megjithate AK në fazën e ri-vlerësimit të kërkoj edhe një interpretim nga KRPP se si të veprohet tutje në këtë rast kur të dy OE janë pjesëmarrës në një aktivitet të prokurimit dhe kanë aplikuar ndaras dhe kanë referenca të njëjta për kontrata paraprake. Sikur se në këtë aktivitet të mos kishte aplikuar njëri OE atëherë do të kishte ndryshuar gjendja sepse paneli do ta konsideronte si të mirëqenë secilen referencë pavarësisht a ka qenë lider i konzorciumit në kontratat paraprake apo jo, deri sa një gjë e tillë nuk definohet qartë me legjislacion.

Sa i përket pretendimit të GOE ankues lidhur me nënshkrimet e menaxherit të projektit, që dallojnë nënshkrimet nga marrëveshja e bashkëpunimit, kontrata dhe CV-ja, edhe pse Eksperti

shqyrtues ka kërkuar sqarime nga Z. Mujaj dhe ka marrë konfirmimin përmes adresës së emailit nga Z. Mujaj që të gjitha dokumentet e dorëzuara nga GOE EBK & U-Unique & Pro Ark Construction për këtë projekt janë nënshkruar nga ai vetë, mirëpo paneli shqyrtues konsideron se AK konform nenit 52, paragrafi 7 të LPP mund të kryej një kontroll efektiv mbi vërtetimin e emailit se a është i Z. Mujaj, kjo pasi që nënshkrimet qartazi kanë dallime, kështu që Autoriteti Kontraktues gjatë fazës rivlerësuese mund të kërkojë dëshmi tjera nëse është e nevojshme qoftë edhe dëshmi noteriale që mund të dëshmojë lidhur me vërtetësinë e nënshkimit të Z. Mujaj në dokumentet e paraqitura.

- Përfundim –

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59, 60 dhe 72 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**
- OE - **Pro & Co Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: